



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:281381

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06909200

C.nr.8161/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca dhe me bashkëpunëtorin profesional Eliron Olluri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S, nga Prishtina, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Veton Uka, Avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.nr, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së 13 (trembëdhjetë), jashtë seancës gjyqësore me datë 25.02.2025, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.S, ashtu që DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të pagave të trembëdhjeta për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t’ia paguaj për secilin vit shumen prej 734.16 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 2,936.64 €, me kamatë ligjore në shkallë prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 15.12.2023, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumën e përgjithshme prej 124.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

II. REFUZOHEN në tërësi kërkesat e paditësit, me të cilën ka kërkuar që ta detyrojë të paditurën, që paditësit në emër të shpërblimit të pagave të trembëdhjeta për fundvitin 2022 t’ia paguaj shumën prej 734.16 euro, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësueses të tij, me datë 15.12.2023, ka paraqitur padi dhe kërkesëpadi kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura, dhe meqenëse e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj në lidhje me kompensimet e lartcekura, ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë, dhe caktimin e detyrimit për të paditurën për përmbushjen e kompensimeve të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me datë 06.11.2024, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e paditura nuk ka realizuar për asnjë punonjës tek e paditura për shkak të mungesës së mjeteve financiare përveç shpërblimit jubilar. Me propozim për Gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura,

megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga Vërtetimi me numër të referencës 05/3-08SRR/0312/2023, i datës 18.10.2023.

Nga vërtetimi i lartëcekur, gjykata konstatoj se paditësi ka filluar punën tek e paditura prej datës 25.06.2001, si dhe në momentin e lëshimit të këtij vërtetimi, realizon pagën prej 734.16 €.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që ka të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.*

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative 02/2018 dhe 01/2021, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, dhe të njejtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, 2020, 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësve.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020, 2021, gjykata mori për bazë vërtetimin, ku në të shihet paga e saktë që realizohet nga paditësi, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, i takon secilit veç e veç shumat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të ua kompensoi paditësit, pagën e 13-të, për fund vitet 2018, 2019, 2020, 2021. Andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ju kompensoi shumat e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 09.11.2021, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 15.12.2023, dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Ndërsa lidhur me refuzimin e pagës së trembëdhjetë për fundvitin 2022 gjykata gjeti se fakti vendimtar për tu vlerësuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e mundësisë së aplikimit të nenit 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 ku përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*, gjegjësisht nëse ekziston mundësia buxhetore e të paditurës për të kompensuar pagën e 13-të punëtorëve të saj, për fundvitin 2022.

Çështja e kompensimit të pagës së 13-të për çdo vit kalendarik, është e përcaktuar me dispozitën nga neni 30 par.2 të Udhëzimit të lartcekur, ku nga interpretimi i të njëjtës, rezulton se kompensimi i kërkesës për pagën e trembëdhjetë për fundvitin 2022, është e normuar si detyrim i karakterit jo obligativ apo alternativ, gjegjësisht i kushtëzuar varësisht mundësive buxhetore tek e paditura, që nënkupton se e drejta e paditëses për të realizuar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është thelbësisht e lidhur nga mundësitë buxhetore të punëdhënësit këtu të paditurës. Për një interpretim të tillë, kjo gjykatë iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.Su.A.nr.213/2023, të datës 09.10.2023 për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të personelit policor.

Lidhur me faktin nëse e paditura ka pasur mundësi buxhetore, Gjykata në kuptim të nenit 321 par.1 të LPK-së, faktet e ditura botërisht, fakte këto të cilat janë të njohura për rrethin më të gjerë të njerëzve, nuk ekziston nevoja që palët ndërgjyqëse të i provojnë, rrjedhimisht në çështjen konkrete gjykata ka gjetur se sipas Raportit të Auditimit me për Ministrinë e Punëve të Brendshme, i nxjerrur në qershor të

vitit 2023, i cili ka vënë në pah se e paditura, gjatë periudhës së vitit 2022, ka pasur buxhet të mangët, ashtu që buxheti për paga dhe mëditje ishte 93,170,639€, prej tyre ishin shpenzuar 91,247,431€, kurse buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 993,438€, ku ulja ishte ndikuar nga vendimet e Qeverisë për shkurtime buxhetore në fund vit, ashtu që shpenzimi i buxhetit për paga dhe mëditje për vitin 2022 ishte 98% e buxhetit final, rrjedhimisht kjo organizatë buxhetore – tani e paditura, asnjëherë nuk ka disponuar me buxhet të mjaftueshëm deri në fund të vitit për të plotësuar nevojat për këtë kategori.

Bazuar në provat e lartcekura është vërtetuar fakti se e paditura si organizatë buxhetore e pavarur është ballafaquar me vështirësi në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që kanë të bëjnë me pagat dhe mëditjet e punëtorëve, në këtë kuptim, e paditura ka arritur ta provojë faktin se nuk ka mundësi buxhetore për përmbushjen e obligimit i cili rrjedh nga neni 30 par.2 të Udhëzimit Administrativ me nr.01/2021 për rregullimin e marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës (PK), përkatësisht kompensimin e pagës së 13-të për vitin kalendarik 2022, e cila ka qenë kërkesë shqyrtimi i kësaj çështje kontestimore.

Ligji Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës Së Kosovës Për Vitin 2022, në nenin 12 paragrafi 5 dhe 6 ka përcaktuar se “5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, është i kufizuar në rrethanat kur ka bazë ligjore të qartë sipas këtij ligji, ndonjë ligji tjetër, apo ndonjë akti nënligjor për ato shpenzime, dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet që të paguhen shtesa për punonjësit e rregullte nga kjo kategori.”, kurse paragrafi 6 parasheh “6. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjisllacionit përkatës.

Kurse sa i përket linjave tjera buxhetore, sikurse kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, Mallra dhe Shërbime, në kuptim të nenit 12 të Ligjit të lart cekur, është përjashtuar mundësia që më të njëjtat të paguhen shtesat, qoftë si kontribute në mall, shujta apo dhurata për punonjësit e rregullt pranë të paditurës, gjegjësisht është përjashtuar mundësia e fuzionimit të linjave buxhetore me njëra tjetrën.

Andaj mbi bazën e lartcekurave, duke pasur parasysh pamundësinë buxhetore të të paditurës, në vlerësimin pëfundimtar të Gjykatës gjendja faktike nuk gjen kualifikim të plotë mbi dispozitën e nenit 30 paragrafi 2 të UA 01/2021, me çka u përcaktua pasoja juridike e vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjegjësisht refuzimi i kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për fundvitin 2022.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtat. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë

Numri i lëndës: 2023:281381
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06909200

provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata është në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësve ju pranohen shpenzimet në shumë prej 124.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104.00 € dhe në emër të taksës për padi shumë prej 20.00 €. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë, dhe jo për veprime të tjera procedurale të cilat nuk janë ndërmarrur në këtë çështje lëndore.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.8161/23 datë 25.02.2025.

Gjyqtarja
Rezarta Sylejmani Voca

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:281381
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06909200